



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Mitrovica Sever - Municipality of Mitrovica North

D.SH.P.I.I.E

Nr. _____ . Data: 02/09/2024.

Mitrovicë Veriore.

Njesia Org. Org. Jedin Org. Unit:	05	Nr. Prok. Br. Prok. Proced.	05-030/1-004594/24
Nr. ifaqeve Br. stranice No. pages:	1	Data Datum Date:	02/09/2024

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë - Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Infrastrukturë, Inspektion dhe Situata Emergjente, duke u bazuar në nenin 51 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nxjerr këtë:

V E N D I M

(Për konfirmimin e Marrëdhënies së Punës)

- KONFIRMOHET** vazhdimi i marrëdhënies së punës për nëpunësin e shërbimit civil z. [REDACTED] [REDACTED] Inspektor i Shërbimeve Publike.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

A r s y e t i m

Nëpunësi z. [REDACTED] është emëruar në detyrë përmes akt emërimit Nr. 01-112/08-0003192/24 të datës 18.03.2024, në pozitën: Inspektor i Shërbimeve Publike.

Pas njoftimit të njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore përmes të cilit kërkohej nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë që të bëhet vlerësimi i punës provuese për nëpunësin z. [REDACTED] me datën 02.09.2024 është realizuar takimi mes nëpunësit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, ku është bashkëbiseduar për vlerësimin e punës së tij provuese. Njoftimi për takimin lidhur me vlerësimin e punës provuese i është dërguar nëpunësit tri (3) ditë para datës së takimit. Gjatë bashkëbisedimit me nëpunësin është konstatuar realizimi i kënaqshëm i detyrave të punës, gatishmëria, kreativiteti dhe vetë-iniciativa për kryerjen e detyrave të punës, respektimi i rregullave të mirësjelljes në shërbimin civil dhe respektimi i orarit të punës.

Bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën ankese në afatin prej 30 ditësh, prej ditës së pranimit të vendimit, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



I dorëzohet:

1x1 Nëpunësit

1x1 Zyrës së Personelit

1x1 Arkivit